



Biografi e shkurtër

Elona Gjergjani (Haska), në vitin 2004 diplomohet për shkenca juridike në fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Krajovës, Rumani, i njohur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës si master i Shkencave në Drejtësi. Ka mbi 14 vite eksperiencë pune në administratën publike, ku ka shërbyer në sektorë të ndryshëm të Ministrisë së Drejtësisë, në pozicionin e specialistes, inspektore dhe përgjegjëses së sektorit. Ka përvojë pune në kërkimin ligjor, draftimin e legjislacionit, hartimin e politikave dhe planeve të veprimit; hartimin e analizave, studimeve, manualeve dhe raportimeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor, drejtësinë për të miturit, edukimin ligjor dhe për çështje të tjera që përfshihen brenda fushës së drejtësisë. Ka qenë pjesëmarrëse në një sërë konferenca, seminare dhe aktivitete trajnuese brenda dhe jashtë vendit. Zotëron gjuhën rumune, angleze dhe italiane. Aktualisht, ushtron detyrën e këshilltares ligjore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.